



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.5030/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Halide Reka e Enes Mehmeti anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M. B nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqësojnë B. K dhe F. G të dy avokat në Prizren, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – DKA, të cilën e përfaqëson Blerim Mazreku avokat në Prizren, për kompensimin e shujtave ditore, duke vendosur sipas ankesës të palës së paditur, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.4329/2022 të datës 19.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.4329/2022 i datës 19.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit, aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M. B nga Prizreni. Në pikën II., të dispozitivit detyrohet e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që paditëses M. B, që në emër të shujtave ditore për 153 ditë të pranisë në punë prej datës 01.01.2022 deri më 15.11.2022, të ia kompensojë shumën prej 306.00 € (treqind e gjashtë euro) dhe atë me kamatë ligjore prej 8 % në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë (12.01.2023) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm. Në pikën III., të dispozitivit detyrohet e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore shumën prej 124 € (njëqind e njëzet e katër) euro në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, ka parashtruar ankesë e paditura, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet apo të priset aktgjykimi i atakuar dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe vendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja M. B ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses në emër të shujtave ditore për 153 ditë të pranisë në punë prej datës 01.01.2022 deri më 15.11.2022, të ia kompensojë shumën prej 306.00 € dhe atë me kamatë ligjore prej 8 % në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë (12.01.2023) deri në pagesën definitive.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike se: paditësja M. B është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës në ..., në fshatin ..., Komuna e Prizrenit, e njëjta në periudhën 01.01.2022-15.11.2022 ka prezantuar në punë gjithsej 153 ditë. Gjykata e shkallës së parë ka gjetur gjithashtu se, e paditura nuk e ka përmbushë detyrimin ndaj paditëses, detyrim ky i cili rrjedhë nga Kontrata Kolektive.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimin të atakuar me ankesë.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Për sa u përket pretendimeve ankimore lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike dhe aplikimin e të drejtës materiale, Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se, kërkesëpadia e paditëses si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë, gjen mbështetje në nenin 35.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, i cili përcakton se *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Nga shkresat e lëndës dhe procedura e zhvilluar, rrjedhë se paditësja M. B, ka 153 ditë pune, për secilën ditë pune shuma e pagesës është nga 2 euro, ndërsa shuma e përgjithshme që duhet t’i kompensohet paditëses është 306.00€.

Pretendimet e palës së paditur të thëna në ankesë së bebeficionet e paditëses që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, janë në kundërshtim me Ligjin e Punës, kolegji i pa refuzuar si të pa bazuara, pasi me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kolegji gjen gjithashtu se, në nenin 322.3 të LPK-së është përcaktuar se: *“Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*.

E paditura përveç kontestimit verbal, nuk ka ofruar ndonjë provë që do të provonte një gjendje tjetër nga sa është vendosur. Në nenin 319.1 i LPK-së përcakton se: "*Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*". Sipas vlerësimit të kolegjit, pala e paditur nuk ka arritur që të bëjë një gjë të tillë andaj edhe pretendimet ankimore janë refuzuar si të pa bazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5030/2023 me datë 05.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj